



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 28/2023 Regjistri (JR)
Datë 04.07.2023

Nr. 10 i vendimit
Datë 05.03.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykesues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 05.03.2024, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Steven Kessler, me sekretare gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në përfundim të procesit të rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë ka konkluduar se: *i. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. ii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*
3. Në përfundim, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 658, datë 12.05.2023, Komisioni vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petraq Çuri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*
4. Subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri, në datën 23.06.2023, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi, riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Ndërsa në parashtimet e paraqitura në Kolegj në datën 15.02.2024, subjekti ka kërkuar përfundimisht prishjen e vendimit të Komisionit si absolutisht të pavlefshëm, pushimin e gjykimit të çështjes në Kolegj, si dhe rregullimin e pasojave të ardhura nga vendimi i Komisionit në aspektin material dhe moral.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

5. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të

Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

6. Ankuesi, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe, në zbatim të nenit F, pika 2, të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
7. Ankuesi legjitimohet dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016¹.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

8. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen që lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 658, datë 12.05.2023.
9. Gjatë shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, i mbledhur në dhomë këshillimi, konstatoi se subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri në datën 13.06.2023 kishte mbushur moshën e përcaktuar nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), për të dalë në pension pleqërie². Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se duhej vlerësuar paraprakisht plotësimi i kushteve ligjore për përfundimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit.
10. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri në datën 20.02.2023 i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) me kërkesë për dalje në pension, bazuar në nenin 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në datën 13.06.2023 mbush moshën 67 vjeç dhe për këtë kërkoj që në këtë datë të largohem nga detyra e magjistratit.
11. KLGj-ja, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit Petraq Çuri për mbarimin e statusit të magjistratit mbi motivin e “*arritjes së moshës së pensionit*”, bazuar në nenin 64, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. {***}, datë 14.06.2023, “Për mbarimin e statusit të

¹ Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri është shpallur në seancë publike më datë 12.05.2023. Vendimi i arsyetuar nr. 658, datë 12.05.2023, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2023, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 10.06.2023. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë pranë Komisionit, në datën 23.06.2023, ankimin e tij kundër vendimit nr. 658, datë 12.05.2023.

² Neni 64 [...] 5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç.

magjistratit”³, ka vendosur: - *Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Petraq Çuri, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. - Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.06.2023. - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.*

12. Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 14.06.2023, të KLGj-së dhe siç parashtron vetë në ankimin drejtuar Kolegjit, në momentin e përgatitjes së ankimit, është në pension pleqërie, që nga data 13.06.2023.
13. Në ligjin nr. 96/2016, në nenin 64, pika 1, përcaktohet se: *“Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji [...]”*. Ndërsa, sipas pikës 5 të po këtij neni, në të cilën është parashikuar dhe procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit, pasi plotësohen kushtet e parashikuara në ligj për daljen në pension pleqërie: *“Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. [...] Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës”*.
14. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se konstatohen këto rrethana: (i) subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit me mbushjen e moshës 67 vjeç, duke i drejtuar për këtë qëllim kërkesë KLGj-së; (ii) KLGj-ja, me vendimin nr. {***}, datë 14.06.2023, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Petraq Çuri, për shkak të mbushjes së moshës 67 vjeç; (iii) vendimi nr. {***}, datë 14.06.2023, i KLGj-së, për mbarimin e statusit të magjistratit, ka marrë formë të prerë; (iv) në momentin e regjistrimit të ankimit në Kolegjit, në datën 04.07.2023, ankuesi nuk e gëzonte më statusin e magjistratit.
15. Trupi gjykues vëren se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë 67 vjeç, ka shprehur me kërkesë vullnetin e tij për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 64, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, ka deklaruar me vendim mbarimin e statusit të magjistratit për z. Petraq Çuri, ai nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës⁴ dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016⁵.
16. Në vlerësim të trupit gjykues, rrethanat e mësipërme përbëjnë shkak për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri pa një vendim përfundimtar, pasi objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur dhe procesi nuk mund të vazhdojë në Kolegjit, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit për efekt të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, trupi

³ Përcjellë në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. {***} prot., datë 19.06.2023.

⁴ “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

⁵ “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”.

gjykues vlerëson se ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit, ka mbetur pa objekt.

17. Nisur nga fakti se subjektit të rivlerësimit i ka mbaruar statusi i magjistratit për një nga rastet e parashikuara nga ligji, në kushtet kur Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në rastin e daljes në pension të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, bazuar në pikën 6, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se mund të zbatohet parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe konkretisht nenit 95 të tij të titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, i cili parashikon se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

VENDOSI:

Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.03.2024.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 10, datë 05.03.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur *përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur*, për këto arsye:
2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, paraqitet kjo situatë faktike:
 - 2.1. Subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.
 - 2.2. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në bazë të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 658, datë 12.05.2023, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petraq Çuri*, mbështetur në konkluzionet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 të këtij ligji, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.
 - 2.3. Duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionit, më datë 23.06.2023, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim, duke kërkuar: (i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative; (ii) shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke dëgjuar subjektin në seancë publike; (iii) ndryshimin e vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit, riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera dhe konfirmimin e tij në detyrë.
 - 2.4. Me parashtrimet e paraqitura në Kolegj më datë 15.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përfundimisht, -- prishjen e vendimit të Komisionit, si një vendim absolutisht i pavlefshëm, -- pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje, pasi gjykimi nuk mund të vazhdojë, -- rregullimin e pasojave të ardhura në aspektin material dhe moral, duke e dëmshpërblyer.
 - 2.5. Shumica e trupit gjykues në Kolegj, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri në datën 13.06.2023 kishte mbushur moshën e pensionit, 67 vjeç, sipas parashikimit të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, çmoi të vlerësonte plotësimin e kushteve ligjore për përfundimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit.
 - 2.6. Nga aktet në dosjen gjyqësore, më datë 20.02.2023, gjatë procesit të rivlerësimit, rreth tre muaj përpara se Komisioni të merrte vendimin objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit, në bazë të nenit 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për daljen në pension, duke u shprehur se *në datën 13.06.2023 mbush moshën 67 vjeç dhe për këtë kërkoj që në këtë datë të largohem nga detyra e magjistratit*. KLGj-ja, me vendimin nr. {***}, datë 14.06.2023, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”,

ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Petraq Çuri, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.

3. Përveç kërkesës drejtuar KLGj-së, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka manifestuar një sërë veprimesh/sjelljesh të evidentuara qartë në vendimin e Komisionit, e që kanë çuar këtë të fundit në zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁶ ndaj subjektit të rivlerësimit, për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, veprime këto që konsistojnë kryesisht në kërkesa të vazhdueshme, të përsëritura dhe haptazi të pabazuara, për shtyrje të afatit në paraqitjen e përgjigjeve të pyetësorit dhe rezultateve të hetimit administrativ, me qëllim zvarritjen e këtij procesi deri në muajin qershor, që përkonte me kohën e daljes së tij në pension.
4. Referuar parashikimit të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016: “[...] *Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës*”. Në këtë kuptim, me mbushjen e moshës së pensionit, magjistrati nuk i drejtohet me kërkesë këshillit përkatës, për t’i bërë të ditur që plotëson kushtet për pension pleqërie, pasi është vetë këshilli, që në rolin e punëdhënësit deklaron kryesisht mbarimin e statusit të magjistratit.
5. Në këtë rast, dalja në pension e subjektit të rivlerësimit nuk duhet konsideruar striktësisht në kuadër të normalitetit të një procesi të pavarur nga vullneti i subjektit të rivlerësimit, por duhet vlerësuar në tërësinë e tij, së bashku me veprimet e subjektit të rivlerësimit dhe mungesën e gatishmërisë së treguar për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit me seriozitet. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, ndonëse kërkesa drejtuar KLGj-së nga pikëpamja formale nuk përfaqëson dorëheqje nga detyra, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ishte përfshirë tashmë në procesin e rivlerësimit, veprimet e tij gjatë procesit, kërkesa drejtuar KLGj-së, përpara se ai mbushte moshën për pension, si dhe kërkesat e shumta për shtyrje afati në kthimin e përgjigjeve ndaj Komisionit, dëshmojnë qartë përpjekjet e subjektit për t’iu shmangur këtij procesi rivlerësimi, dhe për ta përfunduar atë pa një vendim përfundimtar.
6. Në mbështetje të situatës faktike më sipër dhe në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, unë gjyqtare në pakicë, vlerësoj se vendimmarrja e shumicës ka shkuar përtej parashikimeve të nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që në mënyrë shteruese përcakton se: “*Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelit vendos: (a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; (b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; (c) prishjen e vendimit të Komisionit*”. Në rastin konkret, shumica e trupit gjykues vendosi *përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur*, pa u shprehur për fatin e vendimit të Komisionit, edhe pse objekt të vendimmarrjes kishte pikërisht *shqyrtimin e vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*. Sa më sipër, vlerësoj se në çështjen e rivlerësimit të subjektit Petraq Çuri, Kolegji nuk kishte hapësirë tjetër ligjore për

⁶ Shih, paragrafët 21, 260 dhe 261 të vendimit nr. 658, datë 12.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

të vlerësuar sjelljen e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit përveçse nëpërmjet zbatimit të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi